



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 413/9 prot.

Tiranë, më 01 . 09 . 2025

V E N D I M

Nr. 205 , datë 01 . 09 . 2025

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në bazë të vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nëpërmjet vendimit nr. 4024 (80-2024-4093), datë 06.11.2024, ku përcaktohet, ndër të tjera: “*Detyrimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të marrë në shqyrtim ankesën nr. 142 Regj., datë 18.07.2023, të paditësit Xh. Sh*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka regjistruar ankesën nr. 55, datë 04.03.2025¹, të shtetasit Xh. Sh, ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*” nga ana e ish-punëdhënësit, Bashkisë Bulqizë, si dhe ka filluar procedurat administrative për shqyrtimin e saj.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parantezë në lidhje me ankesën.

Kronologjia e fakteve sipas akteve të ankesës:

- Në vitin 2015, ankuesi Xh. Sh është larguar nga detyra si Përgjegjës i Zyrës Ekonomike, në Njësinë Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë.

¹ Për efekt të fillimit të afateve procedurale, është kryer reregjistrim i ankesës nr. 142, datë 18.07.2023, i z. Xh. Sh.

- Pas ezaurimit të rrugës gjyqëore (deri në marrjen formë të prerë të vendimit), në lidhje me largimin nga puna, konkretisht vendimit nr. 2574, datë 25.06.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ankuesi i është drejtuar KMD-së me ankesën me nr. 142 regj., datë 18.07.2023, duke pretenduar se, në vitin 2015, i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës nga Bashkia Bulqizë, për shkak të bindjeve të tij politike.
- Komisioneri, me vendimin nr. 139, datë 26.07.2023, ka vendosur: *“Mospranimin e ankesës me nr. 142 regj., datë 18.-7.2023, të z. Xh. Sh, pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.”*
- Ndaj vendimit të mësipërm të KMD-së, ankuesi Xh. Sh ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 4024 (80-2024-4093), datë 06.11.2024, ka vendosur: *“Shfuqizimin e vendimit nr. 139, datë 26.07.2023, të KMD-së dhe detyrimin e palës së paditur (KMD), që të marrë në shqyrtim ankesën me nr. 142 regj., datë 18.07.2023, të paditësit Xh. Sh.”*
- Në këto kushte, në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës, Komisioneri nuk vë në diskutim afatin kohor të paraqitjes së ankesës së subjektit Xh. Sh, por do ta shqyrtojë në themel atë.
- Gjykata ka vërejtur se²: *“Në ankesën fillestare ankuesi Xh. Sh përveç pretendimit për diskriminim për arsye politike dhe gjendjes familjare, në lidhje me largimin nga puna në vitin 2015, i cili me vendim gjyqësor të formës së prerë është konstatuar si zgjidhje e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, pretendon se diskriminimi përbën një situatë vazhduese, në lidhje me rekrutimin në punë. Pala e paditur, KMD, nuk ka marrë për bazë këtë pretendim, duke kufizuar të drejtën e aksesit të subjektit ankues për shqyrtimin në themel të pretendimeve të tij.*
- Ldhur me citimin e mësipërm të Gjykatës, të pretendimit të ankuesit, për një situatë vazhduese, në lidhje me rekrutimin në punë, Komisioneri vlerëson se, mbetet në kuadër deklarativ, pasi:
- Ankuesi nuk ka shpjeguar, argumentuar e provuar se ka aplikuar përsëri për vende vakante, pozicione pune, sipas kriterëve për t’u punësuar në Bashkinë Bulqizë (pas largimit) dhe të jetë diskriminuar (sipas pretendimit të tij për diskriminim vazhdues), skualifikuar për shkak të bindjeve politike.
- Ky pretendim mbetet hipotetik dhe hamendësim i ankuesit, përderisa ai nuk jep asnjë të dhënë se kur ka aplikuar: datën, muajin, vitin, për çfarë pozicion pune ka aplikuar pranë Bashkisë, etj.
- Po ashtu, referuar dokumentit të lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës, lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, konstatohet se ai, posedon “shkallë të plotë invaliditeti”, (dokumenti mjekësor, lëshuar në vitin 2017) fakt ky, që përben ndalim dhe pengesë ligjore lidhur me punësimin e tij nga viti 2017 e në vijim.
- Në shqyrtim të këtij pretendimi për diskriminim vazhdues lidhur me rekrutimin e tij në punë, Komisioneri e vlerëson si haptazi të pabazuar.

² Fq. 6, e vendimit sipërcituar të Gjykatës.

II. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në shpjegimet e dhëna në ankesën³ e depozituar pranë KMD-së, subjekti ankues, thekson ndër të tjera se:

“...Kam qenë banor i fshatit Lladomericë, ndërsa prej 2 vitesh jam shpërngulur dhe banoj në Njësinë Administrative Sukth, Bashkia Durrës. Për 25 vite kam ushtruar detyra të ndryshme në administratën publike, ku kam punuar për 5 vite si Agronom pranë Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në Bulqizë dhe pjesën tjetër si punonjës në ish Komunën Ostren, sot Njësia Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë.

Duke qenë se jam me prejardhje nga një familje e thjeshtë, që për një kohë shumë të gjatë kemi vuajtur pasojat e persekutimit të regjimit komunist, me ndryshimin e sistemit dhe me ardhjen e pluralizmit në Shqipëri, jam angazhuar si anëtar në Partinë Demokratike të Shqipërisë dhe pjesë e strukturave që në fillimet e saj. Ky angazhim më ka kushtuar shumë në disa raste, duke më larguar padrejtësisht nga puna, pasi në kushtet e zonës ku kam banuar ka qenë në nivele absurde lufta politike. Rastin e parë e kam pasur pas vitit 1997 me rotacionin politik, ku me ardhjen e Partisë Socialiste në pushtet, jam shkarkuar nga puna që ushtroja si nëpunës pranë Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në Bulqizë, pa arsye objektive por vetëm me motive politike.

Edhe pse kam shpresuar se me kalimin e kohës institucionet publike do të distancoheshin nga lufta politike mes partive, kjo gjë nuk ka ndodhur. Kjo vërtetohet edhe në diskriminimin që më është bërë sërish për shkak të bindjeve të djathta, ku menjëherë pas rotacionit politik në vitin 2015 në pushtetin vendor, unë në këtë zonë jam goditur politikisht dhe në shkellje të ligjit.

Pas ndryshimit politik të drejtimit të Bashkisë Bulqizë, e cila veproi me shpejtësi për largimin nga puna në mënyrë të padrejtë dhe në shkellje të ligjit, pa asnjë motiv të arsyeshëm, më larguan nga pozicioni i punës që ushtroja si Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Ostren. Largimi ishte tërësisht politik, pasi ndryshe nga sa komunikohet në vendimin e shkarkimit nga detyra, ku thuhej se vendi i punës do të shkrihej, ndodhi e kundërta, jo vetëm që nuk u mbyll, por zyra në fjalë u shtua dhe me një punonjës tjetër. Për të arritur në këtë përfundim duhet vlerësuar edhe fakti që, unë kam qenë anëtar i Partisë Demokratike dhe gjatë fushatës jam “kërcënuar” për largimin nga vendi i punës nga militantë mbështetës të kandidatit të Partisë Socialiste, çka u konkretizua menjëherë me ardhjen e tij në krye të Bashkisë Bulqizë.

Duke mos pasur mundësi të tjera zgjidhjeje për padrejtësinë që më ishte bërë, zgjodha që t’i drejtohem Gjykatës. Dhe pas një kalvari të gjatë gjyqësor, ku institucioni i paditur ka krijuar pengesa me ankimime për të penguar procesin, në fund arrita të fitoj gjyqin. Më konkretisht, me vendimin nr. 2574, datë 25.06.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kam fituar gjyqin ndaj Bashkisë Bulqizë.

³ Shpjegimet e ankuesit janë dhënë në kuadër të ankesës me nr. 142 Regj., datë 18.07.2023, dhe konsiderohen të vlefshme edhe për ankesën nr. 55 Regj., datë 04.03.2025, me të njëjtin objekt dhe subjekt kundër së cilit drejtohen pretendimet për diskriminim, bashkarisht dhe në koherencë me kërkimet e depozituara nëpërmjet e-mailit datë 13.03.2025.

Këtë vendim e konsideroj si shpërblim për padrejtësinë administrative që më është bërë, por të pamjaftueshme për rikuperimin e dëmit moral, shëndetësor dhe psikologjik që më është shkaktuar. Kjo pasi, sulmi politik që më është bërë mua por edhe familjarëve të mi, më shkaktoi rëndim psikologjik dhe social-ekonomik. Si kryefamiljar dhe me peshën e të ardhurave familjare të rënduara ku u gjenda papritur, me tre fëmijë që po ndiqnin shkollën në qytete të tjera dhe që kishin shpenzime, me dy prindër në moshën e pleqërisë, me motrën dhe gruan pa punë (pasi edhe ato ishin hequr padrejtësisht nga puna) dhe pa asnjë mundësi punësimi dhe me një kredi konsumatore që ishte në proces likuidimi, në datën 23.04.2017 pësova goditje në tru, ku sipas diagnozës të spitalit quhet “AVC Ishemik” duke më paralizuar gjysmën e trupit. Në përshkrimin e doktorit, kjo goditje ka ardhur si shkak i stresit dhe depresionit. Praktikisht lidhet drejtpërdrejtë edhe me goditjen politike që m’u bë familjarisht. Pasojat e asaj goditje vijnë edhe sot e kësaj dite, ku unë jam i paralizuar dhe vërtetohet me pensionin e invaliditetit.

Theksoj se nuk kam pasur asnjë raport konfliktual dhe/ose armiqësie, personale apo familjare, me asnjë person, aq më pak me eprorët e mi. Shkelje të rënda apo të lehta të disiplinës në punë nuk kam kryer për aq vite sa kam shërbyer në Njësinë Administrative Ostren. Mbetet që, përzgjedhja për t’u “sakrifikuar” duke u larguar nga puna ka lidhje vetëm me qëllimin për të përcaktuar në mënyrë demonstrative në vendin tim të punës persona të tjerë që të gjithë këta të përfshirë në aktivitete me natyrë politike. Pra, largimi im nga puna dhe emërimi në vendet përkatëse të zëvendësuesve nuk lidhet me asnjë shkelje disiplinore, as me raportet konfliktuale dhe/ose armiqësore të familjes time, por vetëm me preferencat mbi baza partiake të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë. Situata duhet kuptuar thellë e më gjerë në kontekstin e një realiteti specifik, referuar rrjedhës së ngjarjeve në një territor të vogël dhe mes njerëzve që njohin njëri tjetrin, pasi, në rastin e largimit tim nga puna, për të cilin u sajua shkurtimi i vendit të punës, ndërkohë që organika e njësisë administrative u shtua. Por, duke qenë të ekspozuar tashmë si person me bindje politike të kundërta me Partinë Socialiste, u sajua shkaku për largimin nga Njësia Administrative Ostren.

Vështirësitë e krijuara dhe pamundësia për të gjetur punë, pasi edhe lufta politike në zonën ku banonim ishte më e pranishme dhe më e rënduar për një bashkëjetesë normale, u detyrova që të shpërngulesha familjarisht nga fshati Lladomericë të Bashkisë Bulqizë, në Sukth të Bashkisë së Durrësit për të përballuar jetesën.

Duke parë këtë panoramë të zhvillimit të ngjarjeve që përshkrova më lartë, pasojat e kësaj goditjeje që më është bërë vijnë të jenë prezente edhe në ditët e sotme. Për këtë kërkoj nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për hetimin e rastit tim dhe konstatimin e diskriminimit nga ana e Bashkisë Bulqizë, lidhur me largimin tim nga puna, tërësisht mbi shkaqe politike”.

Përsa më lart, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga punëdhënësi për shkak të bindjeve politike, pasi i është ndërprerë kontrata dhe marrëdhëniet e punës, pas fushatës zgjedhore të vitit 2015.

Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës për shkak të bindjeve politike.

III. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 413/1 prot., datë 17.03.2025, ka kërkuar nga Bashkia Bulqizë, informacionin dhe dokumentacionin si vijon:
 - “Informacion dhe argumente sa i përket pretendimeve të ngritura nga ana e subjektit ankues lidhur me largimin e tij nga puna, bazuar mbi shkaqet e bindjeve politike.
 - Kopje të dokumenteve që vlerësoni se shërbejnë si provë për të prapësuar pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Bulqizë, ardhur si pasojë e bindjeve të tij politike, të ndryshme nga ato të Kryetarit të Bashkisë.

- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje”.

2. Në mungesë të përgjigjes lidhur me sa më sipër është kërkuar, KMD, nëpërmjet shkresës nr. 413/2 prot., datë 23.04.2025, i është drejtuar sërish Bashkisë, lidhur me plotësimin e ankesës së tij.
3. Nëpërmjet shkresave me nr. 1945 prot., datë 23.04.2025 dhe me nr. 1970/1 prot., datë 28.04.2025, Bashkia Bulqizë, ka dërguar parashtrimet e saj, duke informuar ndër të tjera, Komisionerin se:

“Në vitin 2015, Bashkinë Bulqizë e preku reforma territoriale, siç ndodhi në të gjithë Shqipërinë. Si shkak i kësaj reforme, shumë pozicione pune u shkrinë së bashku me ish-komunat.

Me reformën e re territoriale, në Njësinë Administrative ngelën vetëm shërbimet bazë që do t’u jepeshin qytetarit dhe pothuajse të gjitha pozicionet u shkrinë, ndër të cilat edhe pozicioni i z. Sh.

Si shkak i kësaj që përmendëm më sipër, edhe vendi i punës së z. Sh është prekur dhe nuk ka ndonjë arsye politike largimi i tij. Procedura e largimit është gjykuar me vendim gjykate, të cilin Bashkia Bulqizë e ka zbatuar. Lidhur me Vendimin e Gjykatës, dhënë në favor të palës ankuese, nga ana e Bashkisë janë shlyer të gjitha detyrimet, sipas përcaktimeve në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Çdo pretendim tjetër është i pabazuar në ligj dhe prova, prandaj kërkojmë nga ju që ta hidhni poshtë pretendimin e z. Sh për shkak se marrëdhënia e punës nuk është ndërprerë për shkaqe politike.”

4. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 413/5 prot., datë 20.05.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

5. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 05.06.2025, me praninë e subjektit ankues dhe përfaqësueses me autorizim⁴, të Bashkisë Bulqizë, znj. A. Ll, punonjëse pranë këtij institucioni.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimet e depozituara prej tyre pranë KMD-së.

Pala ankuese, ndër të tjera, theksoi qëndrimin e tij lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e Bashkisë, duke theksuar se do të dërgonte në vijim, pas seancës dëgjimore, prova që të dokumentonin

⁴ Autorizim i Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, me nr. 2477 prot., datë 04.06.2025.

pjesëmarrjen e z. Sh si mbështetës dhe pjesë e fushatës zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 dhe zgjedhjet vendore të vitit 2015, si anëtar/vëzhgues i subjektit politik, PD në Komisionin e Qendrës së Vitimit Nr. 1057/00, fshati Lladomericë, Bulqizë. Kjo në funksion të provueshmërisë së pretendimit të ankuesit se largimi nga puna kishte ardhur pikërisht si hakmarrje e punëdhënësit/Bashkisë kundrejt tij, për shkak të angazhimit të tij të shprehur politik dhe jo për shkak të ristrukturimit, sikurse ishte argumentuar prej Bashkisë.

6. Pas seancës dëgjimore, subjekti ankues më datë 16.06.2025, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) një kërkesë, nëpërmjet të cilës kërkon të pajiset me një vërtetim që, në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2013 dhe në zgjedhjet vendore të vitit 2015, ka qenë vëzhgues i subjektit PD, në qendrën e votimit nr. 1057/00, fshati Lladomericë/Bulqizë.

7. Nëpërmjet e-mailit datë 23.06.2025, dërguar pranë KMD-së, subjekti ankues, ka sqaruar ndër të tjera, si vijon:

“Para së gjithash, jam i interesuar që të faktoj diskriminimin që më është bërë në momentin e largimit tim nga puna vetëm për bindje politike dhe në shkelje të barazisë para ligjit. Interesi im është vetëm diskriminimi personal për bindje politike duke qenë se largimin e padrejtë nga puna e kanë faktuar vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Që ka qenë për bindje politike, e tregon edhe pretendimi i Bashkisë për shkrirje vendesh pune, por që nuk rezulton që ka ndodhur diçka e tillë....

Lidhur me bindjet politike, çfarë pozicioni kam pasur ne forumet drejtuese të PD Bulqizë, deri në momentin e largimit nga puna, të shoqëruar me dokumentacion provues:

Jam anëtar i Partisë Demokratike që nga krijimi i saj në vitin 1990, për shkak të të shkuarës time sepse kam qenë familje e persekutuar nga ish regjimi komunist. Që nga dita e parë kam qenë anëtar me tesere partie. Për të vërtetuar pozicionet politike që kam mbajtur në PD dega Bulqizë, është:

- Tesera e PD.
- Vërtetimi që ju kam dorëzuar nga dega e PD.
- Po ju vë në dispozicion një kopje të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vitit të vështirë 1997, ku kam qenë kryetar i Zonës Zgjedhore Nr. 26 i propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë. (Dokumenti me PDF). E disponoj këtë kopje për arsye se kam qenë kryetar i gjithë zonës (61 qendrave të votimit në një situatë “luftë” për Shqipërinë).
- 4. Po ju vë në dispozicion emërimin tim në vitin 2016 si Nënkryetar dhe anëtar i Kryesisë i degës së PD Bulqizë.

....

Që nga viti 1990 e në vazhdim kam qenë vëzhgues dhe anëtar i Komisioneve në çdo palë zgjedhje si përfaqësues i subjektit politik Partia Demokratike. I kam dërguar kërkesë KQZ për të më pajisur me një vërtetim që kam qenë anëtar dhe vëzhgues për zgjedhjet 2013 dhe 2015 që unë pretendoj se më është bërë diskriminim, por nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Deklaroj se në vitet kur ka ndërruar pushteti, si në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2013 apo dhe në zgjedhjet vendore të vitit 2015, kam qenë vëzhgues i subjektit Partisë Demokratike në qendrën e votimit 1057/00, që i përketë fshatit Lladomericë, Njësia Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë.”

8. Nëpërmjet shkresës me nr. 413/7 prot., datë 25.06.2025, Komisioneri i është drejtuar KQZ-së, lidhur me kërkesën për informacionin si më poshtë citohet:

“A ka qenë shtetasi Xh. Sh, me numër karte identiteti G80727091L, vëzhgues, anëtar, (i subjektit politik PD) në Komisionin e Qendrës të Votimit nr. 1057/00, të fshatit Lladomericë, Njësia Administrative Ostren/Bashkia Bulqizë, gjatë procesit të zgjedhjeve për kuvendin në vitin 2013 dhe zgjedhjet vendore të vitit 2015?”

9. Në përgjigje të kërkesë së mësipërme të Komisionerit, KQZ, nëpërmjet shkresës me nr. 5319 prot., datë 26.06.2025, ka informuar se:

“...Pas verifikimeve të kryera në dokumentacionin arkivor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në dispozicion, rezulton se, nuk ekzistojnë të dhëna që vërtetojnë angazhimin e shtetasit të sipërpërmendur në cilësinë e anëtarit apo vëzhguesit gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013 dhe zgjedhjeve vendore të vitit 2015.”

IV. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se:

“Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit ankues, Komisioneri vlerëson se objekt i gjykimit e analizës të kësaj vendimmarrje, janë ato pretendime të z. Xh. Sh, mbi bazën e të cilave janë investuar palët gjatë shqyrtimit të ankesës, dhe për e mbi të cilat ka vijuar procedura hetimore, kundrejt subjektit për të cilin ka pretenduar se e ka diskriminuar, Bashkisë Bulqizë, lidhur me largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Ose, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tij dhe punëdhënësit.

Mirëpo, në rastin konkret, në kushtet kur pretendimi i ankuesit për largim të paligjshëm nga puna është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe në momentin e depozitimit të ankesës së tij pranë KMD-së, lidhur me të, ka një vendimmarrje të gjykatës, të formës së prerë, Komisioneri merr të mirëqenë konstatimin e bërë nga gjykata⁵, bazuar në arsyetimin si më poshtë vijon:

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut/GJEDNJ, në jurisprudencën e saj ka sanksionuar se ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë⁶ dhënë nga ndonjë gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e “gjykimit” për qëllime të Nenit 6 të Konventës (shih Hornsby k. Greqisë, 19 Mars 1997).

Neni 132, i kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon se, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim⁷.

⁵ Për analogji citojmë Vendimin nr. 35, datë 09.03.2023, të KMD-së.

⁶ Sanksionuar edhe në legjislacionin e brendshëm kombëtar, në Kodin e Procedurës Civile.

⁷ https://www.gjk.gov.al/web/Funksionet_175_1.php

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese⁴, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mos përfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.*

Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar, në neni 451/a, të tij⁸, ka sanksionuar se:

“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët,, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”.

Bazuar në vendimin gjyqësor nr. 2574, datë 25.06.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezulton se pretendimi i palës ankuese lidhur me paligjshmërinë e largimit nga puna nga ana e ish-punëdhënësit/Bashkisë Bulqizë, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me të ka një vendim gjyqësor, i cili është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për ekzekutim.

Në rrethanat kur jemi para një vendimi të formës së prerë, i cili është i detyrueshëm për zbatim, si dhe në kushtet kur çështja e pretendimit të ankuesit për paligjshmëri të veprimeve të punëdhënësit ndaj tij, është shqyrtuar dhe zgjidhur gjyqësisht; Komisioneri, merr të mirëqenë konstatimet e bëra nga Gjykata dhe vendimin e saj të formës së prerë.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, citojmë se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, *inter alia*, në vendimin e saj, është shprehur se:

“Në rastin konkret, kontrata e punës nga Bashkia Bulqizë, është zgjidhur me motivacionin “për shkak të shkrirjes së ish-Komunës Ostren, si dhe mospërshtatjes së tij me strukturën dhe funksionet e Njësisë Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë, si dhe mungesë të arsimit përkatës”, ndërkohë, në analizë të dosjes objekt gjykimi motivacioni i largimit nga puna i pretenduar nga pala e paditur, nuk gjen mbështetje ligjore në nenin 153, të Kodit të Punës, që të bëhet zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës.

⁸ (Shtuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 77)

Gjykata Adminisitrative e Apelit, arrin në të njëjtat konkluzione, me ato të arritura nga shkalla e parë, dhe vlerëson se zgjidhja e kontratës së punës është kryer në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara...

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, vendimmarrja e Gjykatës e cila është e formës së prerë dhe ka vendosur mbi paligjshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës të z. Xh. Sh, afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe vlerësimin që do t'i bëjë KMD, pretendimit të subjektit ankues, lidhur me largimin e tij nga puna, të konsideruar si të paligjshëm nga ana e punëdhënësit dhe konfirmuar nga ana e Gjykatës.

Në këtë logjikë, Komisioneri vlerëson se, përsa kohë largimi nga puna i z. Sh (zgjidhja e kontratës së punës nga ana e Bashkisë) është konsideruar e vlerësuar si i paligjshëm nga ana e Gjykatës, për rrjedhojë edhe KMD, do ta konsiderojë atë si veprim të padrejtë karshi ankuesit nga ana e ish-punëdhënësit/Bashkisë Bulqizë.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues Xh. Sh, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm nga ana e ish-punëdhënësit, Bashkia Bulqizë, lidhur me largimin e tij nga puna.

B. Shkaku i mbrojtur - Bindjet politike

Mbështetur në nenin 2⁹, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Mbështetur në nenin 9/2 të Kodit të Punës, mbrojtja nga diskriminimi garantohet bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar se: *“Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim,*

⁹*“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”*

kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga ankuesi konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të “*bindjeve politike*” pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, bindje këto të ndryshe me ato të titullarit të ri të institucionit të Bashkisë Bulqizë (zgjedhur dhe emëruar në 2015).

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkakut i bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesi, konsiderohet si shkak i mbrojtur dhe diferencat në trajtim bazuar në këtë shkak janë të ndaluara dhe të mbrojtura nga ligji.

Subjekti ankues, lidhur me provueshmërinë e bindjeve të tij politike, ka depozituar pranë KMD-së, dokumentacionin si më poshtë citohet:

- Libresë Anëtarësie në subjektin politik Partia Demokratike, lëshuar me datë 15.07.2004, nga Kryetari i PD/Dega Bulqizë, z. R. K;
- Vërtetim me nr. 04 prot., datë 12.07.2023, lëshuar nga Kryetari i PD/Dega Bulqizë, z. E. I, në të cilin, ndër të tjera, evidentohet se: “*Z. Xh. I. Sh, është anëtar i PD/Dega Bulqizë, që nga viti 1991, si dhe, ka qenë anëtar në forumet drejtuese të PD/Dega Bulqizë dhe anëtar e vëzhgues në komisionet zgjedhore...*”

Rezulton se, M. D është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Bulqizë në zgjedhjet vendore të vitit 2015, i propozuar si kandidat për Kryetar Bashkie, nga forca politike, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e subjektit ankues, atë të “*bindjeve politike*”, të ndryshme me Kryetarin e Bashkisë Bulqizë, z. M. D, titullar i institucionit dhe ish-punëdhënës i tij, në momentin e largimit nga puna, me datë 12.08.2015.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit nga ana e ish-punëdhënësit/Bashkisë Bulqizë, me “bindjet politike” si shkak i mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se subjekti ankues është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Bulqisë, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë e të paligjshëm të ankuesit (kjo e fundit provuar me vendim gjyqësor të formes së prerë).

Ankuesi ka pretenduar diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, duke argumentuar se trajtimin e paligjshëm ndaj tij, nga ana e Bashkisë, e lidh me faktin se gjatë fushatës për zgjedhjet vendore të vitit 2015, është angazhuar në mbështetje të kandidatit të forces politike të PD-së dhe jo të kandidatit të PS-së, i cili sapo erdhi në detyrë në krye të Bashkisë, e largoi nga puna në shenjë hakmarrjeje politike.

Sa më sipër, Komisioneri, në analizën e bërë prej tij¹⁰ vlerëson se, shkakun e pretenduar të ankuesit, në kuptim të LMD-së, rezulton i provuar dhe dokumentuar bazuar në provat e depozituara prej tij, lidhur me faktin që ka bindje të djathta politike, si anëtar i PD/Dega Bulqizë. Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesi e mbart këtë shkak.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të paligjshme nga ana e Bashkisë, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, por, duke e lidhur atë, me momentin e largimit nga puna të ankuesit, pra me vitin 2015 dhe me faktin e angazhimit të tij publik, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij si vëzhgues i PD/Dega Bulqizë, në Komisionin e Qendrës të Votimit nr. 1057/00, të fshatit Lladomericë, Njësia Administrative Ostren/Bashkia Bulqizë, në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon : “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike,

¹⁰ Shih faqe 26 e vendimit.

arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”.

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.*

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.¹¹

Gjykata Kushtetuese¹², ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.*

Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga kuadri ligjor në fuqi.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së

¹¹ Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

¹² Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹³.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

¹³ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹⁴”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)¹⁵ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.”*

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe në nenin 82, pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund*

¹⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 7511, datë 08.08.1991

¹⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara¹⁶”.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t’i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ shprehet se: “..... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.”¹⁷

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: “....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.”

¹⁶ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

¹⁷ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (*diskriminimi prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues.

Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁸

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtuar nga ankuesi, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar (bazuar në konstatimin e vendimin e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit) se ai i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm lidhur me largimin nga puna, nga ish-punëdhënsi/Bashkia Bulqizë.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i paligjshëm i subjektit ankues, nga ana e Bashkisë, lidhet me shkakun e mbrojtur dhe ka ardhur pikërisht prej tij.

Komisioneri vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, nga ana e ish-punëdhënësit, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, nga ana e Bashkisë për shkak të faktit se, gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2015, ai ishte angazhuar në fushatë për kandidatin e PD-së, dhe jo për forcën politike apo për kandidaturën e z. M. D, (ku Kryetar i Bashkisë u zgjodh z. M. D) dhe se ky fakt ishte i vërtetueshëm, pasi kishte qenë dhe vëzhgues i subjektit politik PD, në Qendrën e Vitimit nr. 1057/00, fshati Lladomericë, Bashkia Bulqizë.

Pra, ankuesi pretendon se Kryetari i ri i zgjedhur në krye të Bashkisë, e largoi atë nga puna, pikërisht për shkak se ai nuk e kishte mbështetur në fushatë atë, duke theksuar angazhimin e tij të shprehur publikisht nëpërmjet pjesëmarrjes së tij, në qendrat e votimit në cilësinë e anëtarit apo vëzhguesit të subjektit politik PD, të ndryshëm nga ai i titullarit të ri të Bashkisë.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri gjykon se, referuar informacionit të disponuar nga KQZ, se: *“Pas verifikimeve të kryera në dokumentacionin arkivor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në dispozicion, rezulton se, nuk ekzistojnë të dhëna që vërtetojnë angazhimin e shtetasit të sipërpërmendur në cilësinë e anëtarit apo vëzhguesit gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013 dhe zgjedhjeve*

¹⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

vendore të vitit 2015”, qënia e ankuesit si anëtar apo vëzhgues i PD-së në zgjedhjet vendore të 2015-ës (shkak për të cilin ka pretenduar sjelljen hakmarrëse të kryetarit të ri të Bashkisë) nuk provohet, e për rrjedhojë nuk mund të ketë shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë e të paligjshëm nga ana e Bashkisë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm ndaj ankuesit nga ana e Bashkisë, lidhur me largimin e tij nga puna (sipas arsytimit të KMD-së në pjesën A, të vendimit), faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar subjekti ankues, është si rezultat i shkakut të pretenduar, *angazhimit të tij në cilësinë e anëtarit apo vëzhguesit gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013 dhe zgjedhjeve vendore të vitit 2015.*

Faktet e pohuara nga ankuesi se qenia e tij si anëtar KQV-je, në vitin 2013, e si vëzhgues në zgjedhjet vendore të vitit 2015, nuk mund të mbulohen apo provohen me parimin e prezumimit. Qenia anëtar KQV-je apo vëzhgues në zgjedhjet e përgjithshme apo vendore, duhet patjetër të provohet, pasi caktimi anëtar KQV-je, si dhe vëzhgues, rregullohet nga Kodi Zgjedhor, me caktimin që bëhet sipas propozimit të subjekteve zgjedhore, duke u emëruar më pas zyrtarisht nga strukturat përkatëse të KQZ-së. Si të tillë, si anëtar i KQV-së, ashtu dhe vëzhguesi, përveç cilësive politike që kanë, me emërimin formal mbartin dhe përgjegjësi ligjore në mbarëvajtjen, evidentimin dhe rregullueshmërinë e procesit të votimit.

Si përfundim, këto dy cilësi që pretendon ankuesi se i ka pasur në vitin 2013 dhe 2015, rezultojnë të pabazuara, pasi ai nuk solli prova shkresore në këtë aspekt, e po ashtu, KQZ, konfirmoi se emri i ankuesit Xh. Sh, nuk figuron si anëtar apo vëzhgues në KQV nr. 1057/00, që i përket fshatit Lladomericë, Njësia Administrative Ostren, Bashkia Bulqizë.

Në këtë rast nuk vlen transferimi i barrës së provës tek ish-punëdhënësi, Bashkia Bulqizë, pasi ankuesi duhet të provojë paraprakisht se ka ushtruar detyrat përkatëse si anëtar e vëzhgues KQV-je (në vitet 2013-zgjedhjet parlamentare e 2015-zgjedhjet vendore) shoqëruar me aktet zyrtare përkatëse.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Bashkia Bulqizë nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe i paligjshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi nuk përbën diskriminim.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t’u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Përsa kohë nuk rezultoi i provuar shkak i pretenduar nga ankuesi (qenia e tij si vëzhgues i subjektit politik PD, në zgjedhjet vendore të vitit 2015, në Qendrën e Votimit nr. 1057/00, fshati Lladomericë,

Bashkia Bulqizë), Komisioneri vlerëson se sjellja e Bashkisë ndaj tij mbetet në kuadër paligjshmërie, por nuk provohet që ajo të jetë motivuar për shkak të bindjeve politike e angazhimit si vëzhgues i një subjekti politik në fushatën zgjedhore të vitit 2015.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues me pretendimin për diskriminim, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që Bashkia të ketë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, z. Xh. Sh, nga ana e Bashkisë Bulqizë, për shkak të bindjeve politike të tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA